

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"MAGIFIMA SERVICE" SHPK

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja dhe Selia

Neni 1: Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot me date **29.06.2021**, ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptare respektivisht Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **" MAGIFIMA SERVICE " SHPK**, formulojme Statutin e saj, si me poshte vijon,

Ortaket e shoqerise jane:


1. **Michele PONZONI**, i lindur ne Cremona- ITALI, i datelindjes **05.05.1970**, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numer identifikimi Pasaporte **YB0886660**.

Neni 2: Objekti

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine si vijon:

Shitje –blerje te impianteve te llamarines, asistence teknike te impianteve te llamarines, import-export.

Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te cdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj (sipas nenit 7 te Ligjit nr.990 1 ,dt.14.04-08).



Neni 3: Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat.

Neni4:Selia

Selia e shoqerise do te jete:

Autostrada Durres - Tirane Km. 4, Zona Kadastrale 2574, Ndertese Njekateshe me nr. pasurie 155/80, Xhafzotaj- Durres .

Kreu II

Kapitali i regjistruar

Neni 5:Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

Kapitali i shoqerise eshte **10.000 (Dhjete mije)** Leke, i ndare **ne 1 kuote**.


Kontributi i ortakeve ne kapitalin e shoqerise eshte vleresuar sipas te dhenave te meposhtme:

1- Michele PONZONI, eshte zoterues i **1 kuote**, me vlere **10.000 leke**, me **100%** pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise.

Neni 6: Pagesa e kuotave

Administratoret mund t'i kerkojne ortakeve pagimin e kontributeve ne para te pashlyera ne lidhje me kuotat e tyre.

Ne rast te mos shlyerjes se kontributeve, sipas percaktimit te administratorit, personi pergjegjes do te paguaje nje kamate vonese mbi shumen e papaguar me interes prej 4% ne vit.



Neni 7: Kalimi i kuotave

Kalimi i kuotave dhe i te drejtave qe njedhin prej tyre, mund te behet me kontrate shitblerje, me dhurim, me trashegimi ose me cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Neni 8: Zmadhimi e zvogelimi i kapitalit themeltar

Asambleja e Pergjithshme, me shumice te kualifikuar, mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve.

Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar te votave.


Kreu III

Asambleja e pergjithshme

Neni 9: Te drejtat dhe detyrimet

Asambjeja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- b) ndryshimet e statutit,
- c) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,
- d) emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar,
- e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- f) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit,
- g) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre,
- h) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise,
- j) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese,
- k) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.




Neni 10: Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- a) Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratori te pakten 2 here ne vit, per te miratuar perkatesisht bilancin vjetor te mbyllur dhe bilancin vjetor parashikues.
- b) Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje shkrese derguar cdo ortaku me peste te zakonshme ose mesazh elektronik. Njoftimi duhet te kryhet te pakten 7 dite perpara dates se caktuar per mbledhjen.
- c) Ortaket, qe zoterojne te pakten 5% te kapitalit te regjistruar kane te drejte te therrasin mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme nepermjet administratorit ose edhe pa ndermjetesimin e tij.

Neni 11: Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

- a) Mbledhja e Asamblese eshte e vlefshme nese ne te marrin pjese ortake qe zoterojne me shume se 30% te aksioneve, per te vendosur per ceshtje te zakonshme. Ne kete rast vendimi i Asamblese eshte i vlefshem nese eshte votuar nga shumica e votave te ortakeve pjesmarres.
- b) Mbledhja e Asamblese, per te vendosur per ceshtje te vecanta si: ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te regjistruar, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqerise, eshte e vlefshme nese ne te marrin pjese ortake qe zoterojne me shume se 50% te kuotave. Ne kete rast vendimi i Asamblese eshte i vlefshem nese eshte votuar nga jo me pak se tre te katertat e votave te ortakeve pjesmarres, (e cilesuar ne kete statut si "shumice e kualifikuar").
- c) Mbledhja e Asamblese drejtohet nga administratori nese eshte e thirrur prej tij. Nese Asambleja e Pergjithshme eshte thirrur nga pakica, atehere ajo kryesohet nga njeri nga ortaket e zgjedhur nga pjesemarrjesit ne ate mbledhje.
- d) Administratori pavaresisht se nuk eshte ortak, ka te drejten e pjesemarrjes si edhe te marri fjalen ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme.



Neni 12: Votat e Pjesemarrësve

- a) Cdo ortak ka te drejta vote ne perpjesetim me vleren nominale te kuotes se tij.
- b) Asnje ortak nuk voton ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet, qe kane te bejne me kuotat, qe ai disponon.

Neni 13: Emerimi i Administratorit

- a) Administrimi si dhe perfaqesimi I shoqerise I besohen te dy administratoreve.
- b) Administratoret emerohen **per 5- vite** nga regjistrimi I shoqerise prane QKR-se, me te drejte ripertesitje, me perjashtim doreheqje apo shkarkimi nga ana Asamblese.


Detyra e Administratoreve i ngarkohet **:Z. Michele PONZONI** te cilit i jepet e drejta e firmes dhe e perfaqesimit te shoqerise.

- c) Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje ne cdo kohe Administratorin nga detyra, me shumice te zakonshme votash, me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave .

Neni 14: Kompetencat e Administratorit

Administratori ka te drejte dhe detyrohet:

- a. te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme,
- b. te perfaqesoje shoqerine,
- c. te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise,
- d. te beje te mundur pergatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe te nenshkruaje bilancin vjetor parashikues per vitin e ardhshem, per tu miratuar nga Asambleja e Pergjithshme, brenda dates 20 tetor te vitit paraardhes.



- e. te beje te mundur pergatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe te nenshkruaje bilancin vjetor te mbyllur, per tu miratuar nga Asambleja e Pergjithshme, brenda dates 20 mars te vitit te ardhshem dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim,
- f. te krijojte nje sistem monitorimi e njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise,
- g. te kryejne regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te shoqerise,
- h. te raportojte perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare,
1. te kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne ligj dhe statut.

Neni 15: Mbledhjet e Administratorit


Administratori kujdeset qe ne libra te posacem te mbaje proces verbalet e te gjitha takimeve te kryera nga ai, si dhe te gjitha mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme.

Kreu VI

Shperndarja e fitimit vjetor te shoqerise

Neni 16: Shperndarja e fitimit vjetor

- a) Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e pergjithshme.
- b) Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t'u shpemdaje ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.
- c) Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.



Kreu VII

Prishja dhe njoftimet

Neni 17: Prishja dhe likuidimi

- a) Ne rast te likuidimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emerone nje likuidator, i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likuidimit.
- b) Me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve te shoqerise, likuidatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Neni 18: Ftesa per kreditorët

Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Shoqeria e publikon dy here kete njoftim, me nje interval prej 30 ditesh, ne faqen e saj te internetit, si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

Neni 19: Perfundimi i likuidimit

- a) Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise
- b) Veprimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershohet pas cregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

Neni 20: Dispozitat e fundit

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e ketij statuti. Per cdo gje tjeter, qe nuk eshte shkruar shprehimisht ne kete statut, zbatohet legjislacioni ne fuqi per shoqerite tregtare, per QKB-ne si dhe cdo ligj tjeter mbi veprimtarine e shoqerive me pergjegjesi te kufizuar.

Ortaku i shoqerise

Michele PONZONI

